



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 

Conference League/
Auda mposht
Dinamon në
rezultatitn 1-0.
Elbasan Arena
- 

Zjarri në Riban të
Mallakastrës rrezikoi
banesat, deputeti i PS
për Report Tv: U
tejkaluua rreziku për jetët e njerëzve dhe
djegien e pronave të tyre! Ndërhyrja nga
ajri është ndërprerë
- 

Kriza e emigrantëve,
Papa Leone XIV lutet
për Coutin Grykasia
po na verbon ndaj
- 

Kryeministria italiane
shfrytëzon krizën e
emigrantëve në
Spanjë, kërkon të
hapen qendra të tjera
riatdheshimi si në
Shqipëri dhe të financohen nga
Bashkimi Europian
- 

Analiza e BBC: Si u
shndërrua vala e
emigrantëve në
Spanjë në një stuhit
politike europiane
nxitur nga rrjetet
sociale

Kronikë

Parandalohet atentati, 5 të arrestuar në Sarandë! Qitësit me pistoletë u kapën pranë banesës së biznesmenit Rexhep Ismaili të vrarë në maj (EMRAT + VIDEO)

Tre muaj pas vrasjes së biznesmenit Rexhep Ismaili në Sarandë, policia arrestoi pranë shtëpisë së tij, 5 të rinj me pistoletë dhe një silenciator. Ata janë nga Kavaja e Tiranë dhe kishin bërë gati armët për qitje. Shënjestra e atentatit ende nuk dihet.

■ Do të kryenin atentat në fshatin Gjashtë, Report Tv siguron fotot e dy autorëve që u kapën me pistoletë në duar

Parandalohet atentati në Sarandë, 5 të arrestuar pranë banesës së Re Report Tv



Watch on

Redaksia 4 Gusht, 11:10 | Përditësimi: 4 Gusht, 15:08


Share Post



5 të rinj të ardhur nga Tirana e Kavaja u arrestuan në fshatin [Gjashtë](#) të Sarandës me 2 pistoletë dhe një silenciator. Policia tha se kishte siguruar informacion se grupi mund të kryente atentat, ndaj organizoi operacionin e koduar "Silenciatori".

Dy kryesorët janë personat që shihni në foto, [Sidorel Moriseni](#), 32 vjeç, banues në Tiranë, dhe [Alfred Kaja](#), 26 vjeç, banues në Kavajë, me precedentë penalë. Sipas policisë, ata u kapën në flagrancë pranë një lokali, teksa po nxirrnin nga makina dy pistoletë, fishekë dhe një silenciator. Sipas policisë, kishin zënë pritë në një zonë pa ndriçim, në pritje të momentit për të kryer vrasjen.

Ndërsa 3 shoqëruesit e tyre u kapën në automjetin e dytë. Ata janë [Vitrin Hoxha](#), 20 vjeç, banues në Kavajë, [Vonis Poka](#), 31 vjeç, banues në Tiranë dhe [Franko Bobja](#), 21 vjeç, banues në Kavajë.



LEXO EDHE:
Ishin bllokuar mes shkëmbinjeve në Malin e Çikës në Vlorë, ndërhyrja me helikopter bën të mundur shpëtimin e 3 turistëve gjermanë (VIDEO)

Policia dyshon se grupi kishte shkuar në [Sarandë](#) për të ekzekutuar një person në zonën e Gjashtës por emri i shënjestrës nuk bëhet i ditur nga hetuesit. Moriseni dhe Kaja po kontrollonin armët në momentin kur ndërhyjnë efektivët.

Burimet bëjnë me dije se të arrestuarit u kapën në një rrugicë pranë banesës së Rexhep Ismailit, biznesmenit që [u vra në lokalin](#) e tij në Qafë Gjashtë.

Vrasja e Rexhep Ismailit më 7 maj tronditi Sarandën. 66-vjeçari, i cili ishte edhe **kryetar i Shoqatës "Çamëria"** u ekzekutua me një plumb në kokë gjatë përplasjes me armë në lokalin e tij. Nga hetimet rezultoi se Ismaili nuk ishte objektivi i sulmit, por u vra pasi ndërhyri për të mbrojtur Viktor Rucin, një **person me precedentë penalë**.

Hetuesit po verifikojnë nëse ndalesa e grupit në këtë zonë ishte rastësore apo lidhet me ngjarjen ku u vra Rexhep Ismaili. Deri tani asnjëri prej të arrestuarve nuk ka dhënë deklaramë për objektivin.

Të arrestuarit
Sidorel Moriseni 32 vjeç, banues në Tiranë
Alfred Kaja 26 vjeç, banues në Kavajë
Vonis Poka 31 vjeç, banues në Tiranë
Vitrin Hoxha 20 vjeç, banues në Kavajë
Franko Bobja 21 vjeç, banues në Kavajë

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:56
Do të kryenin atentat në fshatin Gjashtë, Report Tv siguron fotot e dy autorëve që u kapën me pistoletë në duar



Sidorel Moriseni, Alfred Kaja

Këta janë dy prej autorëve të atentatit të parandaluar në fshatin Gjashtë të Sarandës. Report Tv ka siguruar fotot e Sidorel Morisenit, 32 vjeç dhe Alfred Kajës, 26 vjeç, dyshohet se do të ekzekutonin një person në këtë fshat.

Sipas burimeve ata ndodheshin të ndarë në dy makina dhe në një moment sapo kanë ndaluar, po shihnin armët kur në atë moment është ndërhyrë nga policia për t'i arrestuar. Sipas burimeve, të arrestuarit u kapën në një rrugicë pranë banesës së Rexhep Ismailit, i cili u vra në lokalin e tij në Qafë Gjashtë, në maj të këtij viti.

Grupi hetimor është duke verifikuar nëse ndalesa e tyre në këtë zonë është e rastësishme ose jo, pavarësisht se të arrestuarit nuk kanë dhënë deklaramë.

P.J/Shqiptarja.com

Share

P.J/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: gjashte sarande alfred kaja Vlore sidorel moriseni vitrin hoxha vonis poka franko bobja

Komente Komento

Felofelo: 04/08/2026 12:23
Ky feliksi kudo qe shkon ket muhabet ka.merr njerzit me qaf.vec ky kap arme..hwhahaha.ka nja 2 mallista qe i perdor si karremja ben me hile dhe prokurorise,gjoja hap procedim.ta verifikoj spaku se felua esht vet per burg...

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: Reforma territoriale, cili opsion ju pëlqen më shumë?

31 Korrik, 15:00


46 bashki (PS) 100 bashki (PD) 61 bashki (si sot)

Lajme të tjera



Nesër temperaturat deri në 37°C, IGJEO: Pjesa më e madhe e vendit e rrezikuar nga zjarret

4 Gusht, 18:44




Vonesat në përfundimin e aeroportit të Vlorës për shkak të mosmarrëveshjeve mes kompanive të Pacollit dhe Ademit, Qeveria nis procedurën për anulimin e kontratës koncesionare

4 Gusht, 17:32




Zjarr i madh në Nivicë të Himarës, era favorizon përhapjen e flakëve, zjarrfikësit në vendngjarje (VIDEO)

4 Gusht, 17:06




Policia forcon kontrollin në Gjirin e Vlorës, 32 mjete të bllokuara dhe dy gjoba nga 500 mijë lekë gjatë korrikut (VIDEO)

4 Gusht, 14:05



Vlorë, vijon shembja e objekteve të ndërtuara mbi kanalet kulluese, i hapet rrugë rehabilitimit (VIDEO)

4 Gusht, 12:01



Do të kryenin atentat në fshatin Gjashtë, Report Tv siguron fotot e dy autorëve që u kapën me pistoletë në duar

4 Gusht, 11:56



Të shtënat në Palasë, jahti i Bruno Çelës sapo kishte ardhur nga Italia! Pistat: Të jetër në bord, apo u qëllua nga një mjet i dytë lundrues

Sokol Dema

4 Gusht, 11:31




Aksidenti me furgon në Ksamil, ky është pasagjeri 20-vjeçar që humbi jetën (FOTO)

4 Gusht, 07:54



Zjarret në fshatrat e Finiqit e Delvinës, ministri Nufi: Pilotët e Forcave të Armatosura bënë një punë të jashtëzakonshme për vënien nën kontroll të situatës (VIDEO)

3 Gusht, 21:05



Zjarri në fshatrat e Finiqit, Prefektja e Vlorës për Report Tv: Situata është nën kontroll! Nënkryetari i bashkisë: Flakët ishin intensive, por u izoluan falë ndërhyrjes në kohë

3 Gusht, 20:35



Aksidenti i rëndë në Ksamil, pasagjeri 20-vjeçar humb jetën pas përplasjes së furgonit me të cilin po udhëtonte! Plagoset edhe shoferi (EMRI)

Limos Didani


3 Gusht, 19:26



Zjarri në fshatrat e Finiqit, ministri Lamallari publikon pamare nga evakuimi i banorëve: Situatë e vështirë, prioritet absolut mbrojtja e jetës së qytetarëve (VIDEO)


3 Gusht, 18:27

Lajmi i fundit



Zjarri në Riban të Mallakastrës rrezikoi banesat, deputeti i PS për Report Tv: U tejkalua rreziku për jetët e njerëzve dhe djegien e pronave të tyre! Ndërhyrja nga ajri është ndërprerë

4 Gusht, 20:29





x **[sh]** Lajmi i fundit
.com



**Zjarri në Riban të Mallakastrës
rrezikoi banesat, deputeti i PS për
Report Tv: U tejkalua rreziku për
jetët e njerëzve dhe djegien e
pronave të tyre! Ndërhyrja nga ajri
është ndërprerë**

4 Gusht, 20:29